

URBANISM WATCHUrbanizmi i Prizrenit nën
vëzhgim të përhershëm

10 shtator 2013, Prizren

Komunikatë #3

KOMUNIKATË PËR MEDIA**Ndërtimet pa leje po e dëmtojnë urbanizmin dhe buxhetin komunal**

Nga muaji korrik, “EC Ma Ndryshe” ka nisur zbatimin e projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Nevoja për mbikëqyrjen e zhvillimeve në sektorin e urbanizimit ka rrjedhë si pasojë e zhvillimeve të shumta negative gjatë periudhës së pasluftës dhe tranzicionit që janë manifestuar me degradimin urban dhe planifikimin e pa-balancuar hapësinor. Projekti synon që të instaloj një sistem të monitorimit të përhershëm të aktivitetit shtetëror (dy nivelet e pushtetit dhe organet e drejtësisë) në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit urban në qytetin e Prizrenit, me theks të veçantë në Qendrën Historike të tij, për të siguruar rend urbanistik.

Gjatë muajit gusht “EC Ma Ndryshe” ka shqyrtuar çështjen e lejeve të ndërtimit që lëshohen nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, meqë kjo temë ishte prekur në Raportin e fundit të Auditorit për Komunën e Prizrenit, http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPZ_2012_Shqip_9759.pdf.

Auditorët kanë konstatuar se Komuna e Prizrenit nga lejet e ndërtimit për periudhën e vitit 2012 kishte planifikuar që të realizoj të hyra në vlerë 800,000 €, ndërsa kishte arkëtuar 843,346 €. Ata kanë testuar 8 mostra në vlerën 274,582 € dhe kanë identifikuar si mangësi, mos sigurimin e një bazë të plotë të të dhënave për numrin e kërkesave për leje, lejet e lëshuara, dhe refuzimet për vitin 2012; dhe në tri raste kanë konstatuar se komuna kishte lëshuar vendim për ndërtimin e dy kateve, ndërsa inspektorët në terren kanë vërejtur tejkallime në ndërtimin e objekteve dhe janë ndërtuar më shumë kate se sa është përcaktuar me leje ndërtimi.

“Mungesa e një baze të plotë të të dhënave për lejet e ndërtimit, si dhe tejkallimi i kateve të lejuara të ndërtimit, rritë rrezikun që tarifat të mos kalkulojnë saktë dhe të kemi një nënpagesë të të hyrave”, është rreziku i identifikuar në Raportin e Auditimit, derisa rekomandohet “Kryetari i Komunës që të krijojë një bazë të saktë të të dhënave se sa ka qenë numri i kërkesave për leje, lejet që janë lëshuar dhe ato që janë refuzuar” dhe po ashtu që “rastet e tejkallimit të ndërtimeve të rishikohen dhe si të tilla ose të ndërpriten ose të paguhen tarifat shtesë”.

Në bazë të këtyre vërejtjeve EC Ma Ndryshe ka kërkuar nga DUPH-ja të lejoj qasjen në dokumentet publike, për të parë nëse Komuna e Prizrenit ka krijuar një bazë të plotë të të dhënave që kanë të bëjnë me kërkesat për lejet ndërtimore dhe nëse është zbatuar rekomandimi i Auditorëve.

Nga DUPH-ja është pranuar një letër me përgjigje në kërkesë, në të cilën thuhet se në gjashtëmuorin e parë të vitit 2013 DUPH ka miratuar 90 leje ndërtimore dhe ka refuzuar 31 sosh. Ndërsa lidhur me tejkallimet në ndërtimin e objekteve në vitin 2013 DUPH ka theksuar se “nuk është formuar asnjë listë, për arsye se për të verifikuar tejkallimet e objekteve në qytetin e Prizrenit si dhe verifikimin e objekteve ilegale të ndërtuara

duhet të formohet një komision”. Gjithashtu sqarohet se formimi i kësaj liste hyn në kompetencat e Drejtorisë së Inspektorateve.

Një hulumtim i mëparshëm i EC Ma Ndryshe (mund të gjendet në http://www.online-transparency.org/repository/docs/komunikate_inspektorati.pdf) pat nxjerrë në dritë faktin se edhe Drejtoria e Inspektorateve respektivisht Inspektorati i Ndërtimtarisë nuk posedonte një listë të objekteve pa leje dhe me tejkalime, që duhen rrënuar.

Në bazë të këtyre të gjeturave EC Ma Ndryshe konstaton se Qeveria Komunale nuk po tregon vullnet të mjaftueshëm për të vendosur rend urbanistik në Prizren dhe sipas përfundimeve të Auditorit një gjendje e tillë po ndikon negativisht në urbanizimin e qytetit dhe në buxhetin komunal.

Në i bëjmë thirrje komunës së Prizrenit që në afatin sa më të shkurtër kohor të reflektoj mbi të gjeturat e Auditorit në lidhje me lejet ndërtimore dhe t’i ndër marrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit të dhënë në këtë drejtim.

Ftojme Kryetarin e Komunës që të urdhëroj DUPH-në dhe DI-në që bashkërisht të krijojnë një bazë të saktë të të dhënave për lejet ndërtimore, dhe në bazë të kësaj liste të nisin ekzekutimet në objektet pa leje dhe me tejkalime.

EC Ma Ndryshe kërkon nga Qeveria Komunale e Prizrenit që të veproj konform përgjegjësiave ligjore që ka dhe të marrë veprime konkrete për ndalimin e degradimit urbanistik që tashmë ka marrë përmasa shqetësuese brenda qytetit.

“Urbanizimi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm” do të vazhdoj me monitorimin dhe publikimin e të gjeturave në sektorin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, sikurse edhe me adresimin e përgjegjësisë institucionale.

Me nderime,
Valon Xhabali, Koordinator i Projektit
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren & Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën

vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo